

Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-145489/20 dt. 19.08.2020, në emër të pronarëve Ibrahim dhe Beqir Fazliu nga Prishtina dhe investitorit “Kosova Home” shpk, me seli në Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa individuale banimore/shtëpi banimore: Tipi “1”, Tipi “2”, Tipi “3”, Tipi “4”, Tipi “5”, dhe Tipi “6”, me etazhitet P+1, në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 552-1 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 03.12. deri më 07.12.2020, në e-mail adresën:

urbanizmprihtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Kompleks i ndërtesave individuale banimor/shtëpi banimore Tipi “1”, Tipi “2”, Tipi “3”, Tipi “4”, Tipi “5”, dhe Tipi “6”, me etazhitet P+1
b. Vija rregulluese	Në kufi të parcelës kadastrale
c. Vija ndërtimore	5.0 m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	6.0 m` / 5.0 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	6.0 m` / 3.50 m` 6.0 m` / 4.00÷14.58 m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	30 % (e lejuar) 27 %÷30% (e propozuar)
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	0.6÷0.8 (e lejuar) 2883.15 m ² (e propozuar)
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% (e lejuar) 40.75 % ÷48.43 %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	/
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	18 vendparkime të jashtme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohen në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____

